



## RISHPALLJE E KONKURISIT PËR POZITËN:

### ANALIST I PERFORMANCËS FINANCIARE PËR SHËRBIMET E UJIT DHE MBETURINAVE

#### (1 POZITË)

<b>Departamenti:</b>	Performancës
<b>Raporton te :</b>	Udhëheqësi i Departamentit të Performancës
<b>Vendi i punës:</b>	Pristine
<b>Niveli i pagës:</b>	530 euro
<b>Orari i punës:</b>	1 Plotë
<b>Kontrata:</b>	Një vjeçare me mundësi të vazhdimit

#### FUSHËVEPRIMI I POZITËS

Analisti i Performancës Financiare është përgjegjës për grumbullimin, vlerësimin e saktësisë dhe besueshmërisë, si dhe analizimin e të dhënave të raportuara nga Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave (“Ofruesit e Shërbimeve”).

Për punën e vet Analisti i Performancës Financiare për Shërbimet e Ujit dhe Mbeturinave i përgjigjet Udhëheqësit të Seksionit të Performancës.

#### DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Rishikon dhe përditëson rregullisht kërkesat për të dhënat që duhet të raportohen nga Ofruesit e Shërbimeve;
- Vlerëson saktësinë e të dhënave financiare të raportuara dhe dërgon informatën kthyesë të Ofruesit e Shërbimeve;
- Vlerëson besueshmërinë e të dhënave financiare duke marrë pjesë në auditimet që organizon ZRRUM për këtë qëllim;
- Punon në hartimin e modeleve dhe udhëzuesve për raportim të Ofruesve të Shërbimit;
- Përpunon të dhënat e raportuara dhe interpreton rezultatet e treguesve financiar të performancës së Ofruesve të Shërbimit;
- Punon në hartimin e Raporteve të Performancës të Ofruesve të Shërbimeve – Raportet Gjysmë-vjetore dhe Raportet Vjetore;
- Kryen analiza të aspektit financiar të punës së Ofruesve të Shërbimeve si dhe përgatitë rekomandime për menaxhimin e të dhënave financiare;
- Prezanton, sipas nevojës, para palëve të interesit rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit të performancës financiare të Ofruesve të Shërbimeve;
- Punon në hartimin e legjislacionit sekondar të ZRRUM;
- Kryen punë të tjera sipas nevojës së ZRRUM-it kur kjo kërkohet nga eprorët e tij të drejtpërdrejt.

#### KUALIFIKIMET

- Diplomë universitare në ekonomi;
- Minimum tri (3) vjet përvojë pune relevante në këtë lëmi (financa apo kontabilitet), që preferohet të ketë përvojë në sektorin e shërbimeve publike ose në entitetet që ofrojnë shërbime publike;
- Njohuri shtesë për çështjet e shërbimeve të ujit, ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta në Kosovë;
- Njohuri të punës në të folur dhe të shkruar të gjuhëve zyrtare në Kosovë;
- Njohuri të punës me kompjuter;
- Shkathtësi analitike;
- Aftësi për të prezantuar rezultatet e analizave gjatë punës;
- Aftësi për të punuar si anëtar i ekipit dhe në mënyrë të pavarur.

**DATA E FUNDIT PËR DORËZIMIN E APLIKIMEVE: 08 MARS 2010**

Formulari për aplikim mund të merret pranë Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina.

Aplikacionet duhet te dorëzohen ne zarf të mbyllur duke shkruar mbi te titullin e Postit në adresën e poshtë shënuar:

**Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina**

Rr. Ferat Dragaj. 68, Bregu i Diellit Prishtinë (prapa furrës Qerimi 1)

Tel. +381 38 249 165 110;112 [www.wwro-ks.org](http://www.wwro-ks.org)

**DO TË KONTAKTOHEN VETËM KANDIDATËT QË HYJNË NË LISTEN E NGUSHTË**